

EC Ma Ndryshe, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren, GreenArt, X40, EUIRC, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri

24 janar 2012, Prishtinë

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Protestë qytetare në Prizren, për të kundërshtuar projekt-ligjin për Qendrën Historike

Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve në Mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit, në konferencën për media të mbajtur sot ka publikuar thirrjen për protestë qytetare për të kundërshtuar projekt-ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

Protesta do të mbahet më 29 janar, ditë e diel, me fillim në orën 13.00, ndërsa pikë tubimi do të jetë Sheshi Shadërvan në Prizren. Sipas Koalicionit të OJQ-ve, vendimi për protestë është marrë pas konsultimit me të gjitha grupet relevante të qytetit, të cilët e kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të përkrahur protestën.

Kërkesat e shoqërisë civile janë që ky projekt-ligj të hudhet poshtë, ashtu siç është kërkuar me Peticionin e mbi 10.000 qytetarëve të Prizrenit. Protesta e 29 janarit është thirrur për të dëshmuar se qytetarët e Prizrenit nuk do ta pranojnë këtë projekt-ligj edhe nëse ai miratohet përfundimisht në Kuvendin e Kosovës. Për më tepër, ky organizim qytetar do të jetë edhe paralajmërim për institucionet shtetërore se qytetarët e Prizrenit do të aplikojnë mosbindje qytetare ndaj efekteve të këtij ligji nëse ai miratohet dhe hyn në fuqi.

Në konferencën për media është paralajmëruar edhe dërgimi i këtij ligji në Gjykatën Kushtetuese, në rast se ai hyn në fuqi. Koalicioni i OJQ-ve ka njoftuar se parashtesa për Gjykatën Kushtetuese është tashmë e përgatitur dhe në përpilimin e saj kanë marrë pjesë ekspertë eminentë të vendit dhe ndërkombëtarë.

Gjatë konferencës për shtyp Koalicioni i OJQ-ve të Prizrenit ka përsëritur edhe një herë argumentet e shumta që dëshmojnë se projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit është anti-kushtetues, diskriminues, ngulfatës për zhvillimin dhe se ai nxit konflikte mbi baza fetare dhe etnike.

Koalicioni i OJQ-ve të Prizrenit i ka ftuar të gjithë qytetarët e Prizrenit, pa marrë parasysh orientimet e tyre politike, fetare ose etnike, që të dielën të jenë të bashkuar në protestën qytetare për të kundërshtuar një ligj që do t'i dëmtojë interesat e të gjithë atyre që jetojnë në Prizrenit

Koalicioni i OJQ-ve në Mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit

EC Ma Ndryshe,

Fondacioni për Trashëgimi Kulturore,

Forumit për Trashëgimi Kulturore,

Academy for Training and Technical Assistance,

N'GO,

Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren,

GreenArt,

X40,

EUIRC,

Ura e Artit,

Durmish Asllano,

ICEC,

Old timer Club Prizren,

Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri